

Propozimi perfundimtar per amandmim të Kodit të Rrjetit

KODI I PLANIFIKIMIT

Neni 5.2.1.1 me përmbajtje:

5.2.1.1 Çdo [vit] **OSTT** do të përgatisë dhe lëshojë në qarkullim një **Plan të Zhvillimit të Sistemit të Transmisionit** të detajuar (**TNDP**) për [7] vitet e ardhshme.

Të amandmohet me këtë përmbajtje:

5.2.1.1 Çdo vit **OSTT** do të përgatisë dhe lëshojë në qarkullim një **Plan Zhvillimor të Transmisionit** të detajuar (**PZhT**) për 10 vitet e ardhshme.

Të insertohet neni 6.1.1.2.1

6.1.1.2.1 Ku të dhënat planifikuese janë përfshirë në Shtojcën B të **Marrëveshjes së Kyçjes** relevante, atëherë **Përdoruesi** mund të konfirmojë se të dhënat në at Shtojcë janë korrekte.

Neni 6.1.1.3 me këtë përmbajtje:

6.1.1.3 Për të mundësuar përfundimin e çdo oferte të kyçjes – secili **përdorues** duhet t'i paraqesë **OSTT** të dhënat e planifikimit standard sipas paragrafit 11 dhe të dhënat paraprake të planifikimit të projektit sipas paragrafit 8 me aplikimin e kyçjes dhe brenda [dy] muajve nga dita që pranohet oferta, duhet të paraqiten të dhënat e detajuara të planifikimit sipas paragrafit 11.4.5.

Të amandmohet me këtë përmbajtje:

6.1.1.3 Secili **përdorues** i cili kërkon një **Marrëveshje për Kyçje** të re apo të modifikuar do të dorëzoj **OSTT**-së të dhënat preliminare të projektit sipas paragrafit 8 me aplikacionin për kyçje, dhe do të dorëzoj të dhënat standarde të planifikimit sipas paragrafit 11 dhe të dhënat e detajuara të planifikimit sipas paragrafit 12 në periudha kohore e cila do të specifikohet në **Marrëveshjen për Kyçje**.

Neni 6.1.1.5 të fshihet:

6.1.1.5 **OSTT** do të specifikojë të dhënat standarde të planifikimit dhe të dhënat e detajuara të planifikimit që ai i kërkon për të përmbushur detyrimet e tij të licencës dhe kërkesat e këtij **kodi të planifikimit**. Të dhënat do të jenë disa ose të gjitha ato që specifikohen në Anekset 1 dhe 2 të këtij **kodi të planifikimit**.

Neni 7.1.1.1 me përmbajtje:

- Pasi që ekuivalenti do të përgatitet për pjesët 400 dhe 220 kV të **Sistemit të Transmisionit, OSTT** do të japë të dhënat e duhura të transformatorëve;

Të amandmohet me këtë përmbajtje

- Pasi që ekuivalenti do të përgatitet për pjesët 400, 220 dhe 110 kV të **Sistemit të Transmisionit, OSTT** do të japë të dhënat e duhura të transformatorëve;

Neni 9.2.2.1 me përmbajtje:

9.2.2.1 Plani i mjaftueshmërisë së gjenerimit (GAP) duhet të mbulojë një periudhë 7 vjeçare dhe duhet të adresojë ndaras secilin vit të kësaj periudhe. Plani kryesisht duhet të krahasojë nëse **kërkesa** e pritur mund të plotësohet nga mundësitë e **gjenerimit** në dispozicion brenda standardeve të kërkuara të besueshmërisë dhe duhet të përcaktojë mundësitë për projekte të zgjerimit të **gjenerimit**. Plani e trajton ndaras çështjen e varshmërisë nga importet.

Të amandmohet me këtë përmbajtje:

9.2.2.1 Plani i mjaftueshmërisë së gjenerimit (GAP) duhet të mbulojë një periudhë 10 vjeçare dhe duhet të adresojë ndaras secilin vit të kësaj periudhe. Plani kryesisht duhet të krahasojë nëse **kërkesa** e pritur mund të plotësohet nga mundësitë e **gjenerimit** në dispozicion brenda standardeve të kërkuara të besueshmërisë dhe duhet të

përcaktojë mundësitë për projekte të zgjerimit të **gjenerimit**. Plani e trajton ndaras çështjen e varshmërisë nga importet.

Neni 9.2.6.1 me këtë përmbajtje:

9.2.6.1 **OSTT** do t'ia dorëzojë draft GAP **Rregullatorit** çdo vit në fund të [Shtatorit]. **Rregullatori** do të japë komentet e tij në fund të [Tetorit] dhe versioni final i GAP që përfshin komentet e marra nga **Rregullatori** do të qarkullohet nga **OSTT** për të gjitha **palët** dhe do të vendoset në faqen elektronike e tij në fund të [Nëntorit].

Të amandmohet me këtë përmbajtje:

9.2.6.1 **OSTT** do t'ia dorëzojë draft GAP-in **Rregullatorit** çdo dy vjet në fund të shtatorit, ose edhe më herët nëse kyçja e gjeneratorëve të ri në sistemin elektrik ndodh para afatit të përcaktuar më lartë. **Rregullatori** do të japë komentet e tij në fund të tetorit dhe versioni final i GAP-it që përfshin komentet e pranuar nga **Rregullatori** do të qarkullohet nga **OSTT** për të gjitha **palët** dhe do të vendoset në faqen e tij elektronike në fund të nëntorit.

Në nenin 11.4.1.2 të fshihet:

- “Aranzhmanet e fazave”

Neni 11.4.4.1 me përmbajtje:

11.4.4.1 Informacioni i mëposhtëm kërkohet në lidhje me ndërpererësit (duke përfshirë ndërprerësit e qarkut, ndarësat dhe ndarësat e tokësimit) në të gjitha qarqet e kyçura me **pikën e kyçjes** duke përfshirë atë të **stabilimenteve energjetike**.

Të amandmohet në:

11.4.4.1 Informacioni i mëposhtëm kërkohet në lidhje me të gjitha pajisjet shkyçëse në të gjitha qarqet e kyçura me **pikën e kyçjes** duke përfshirë atë të **centraleve energjetike**.

Të insertohet Neni 11.4.4.2 me këtë përmbajtje:

11.4.4.2 Ky informacion duhet të përfshihet në Shtojcën B të **Marrëveshjes së Kyçjes** relevante.

Të fshihen nenet 11.4.5.1 dhe 11.4.5.2 me këtë përmbajtje:

11.4.5.1 Secili **përdorues** me një sistem ekzistues apo të propozuar 10 KV dhe më tepër që lidh sistemin e **përdoruesit** me **Sistemin e Transmisionit** do të japë detajet e mëposhtme që lidhen me atë **pikë të kyçjes**.

11.4.5.2 Për gjithë qarqet do të jepen parametrat e mëposhtëm të qarqeve:

- Tensioni nominal (kV);
- Tensioni operues (kV);
- Rezistenca, reaktansa dhe susceptanca e sekuencës pozitive të fazës; dhe
- Rezistenca, reaktansa dhe susceptanca e sekuencës zero të fazës.

Neni 12.3.3.1 me këtë përmbajtje:

12.3.3.1 Për transformatorët mes **Sistemit të Transmisionit** dhe sistemit të **përdoruesit**, të dhënat e mëposhtme do të jepen për secilin transformator:

- Fuqia nominale MVA;
- Herësi nominal i transformimit;
- Grupi i lidhjes së brendshme;
- Rezistenca dhe reaktansa e sekuencës pozitive (Pozita maksimale, minimale dhe nominale);
- Reagimi i sekuencës zero;
- Brezi dhe hapi i ndërruesit të pozitive;
- Tipi i ndërruesit të pozitive me ose pa ngarkesë;

- Metoda e tokëzimit: direkte, nëpërmes rezistencës ose nëpërmes reaktansës

Të rinumërohet si 11.4.5.1 me këtë përmbajtje:

11.4.5.1 Për transformatorët mes **Sistemit të Transmisionit** dhe sistemit të **përdoruesit**, të dhënat e mëposhtme do të jepen për secilin transformator:

- Fuqia nominale MVA;
- Herësi nominal i transformimit;
- Grupi i lidhjes së brendshme;
- Rezistenca dhe reaktansa e sekuencës pozitive (Pozita maksimale, minimale dhe nominale);
- Nëse kërkohet nga OSTT, reaktansa e sekuencës zero;
- Brezi dhe hapi i ndërruesit të pozitave;
- Tipi i ndërruesit të pozitave me ose pa ngarkesë;
- Metoda e tokëzimit: direkte, nëpërmes rezistencës ose nëpërmes reaktansës; dhe
- Impedansa nëse nuk është direkt e tokëzuar.

Të fshihet neni 11.4.5.3 me këtë përmbajtje:

11.4.5.3 Për transformatorët mes **Sistemit të Transmisionit** dhe sistemit të **përdoruesit** do të jepen të dhënat e mëposhtme për secilin transformator:

- Fuqia nominale dhe impedanca e transformatorit;
- Grupi i lidhjes së brendshme;
- Pajisja për ndërrimin e pozitave dhe brezi i pozitave

Të insertohet neni 11.4.6 me këtë përmbajtje:

11.4.6 Të dhënat e Qarkut të Kyçjes

11.4.6.1 Aty ku linja apo kabllloja e **përdoruesit** e cila kyçet nga sistemi i **përdoruesit** në **Sistemin e Transmisionit** të cilat janë më gjatë se 100 m, **përdoruesi** duhet të siguroj të dhënat si në vazhdim:

- Tensioni nominal (kV)
- Tensioni Operues (kV)
- Sekuenca pozitive e rezistencës, reaktansës dhe susceptansës
- Aty ku në mënyrë specifike kërkohet nga **OSTT**-ja, rezistenca e sekuencës nulare të rezistencës, reaktansës dhe susceptansës.

Tek neni 12.1.1.1 të fshihet pika e dhjetë “Vendi i kyçjes (susceptansa/burimi i lidhjes së shkurtë)”

Të fshihet neni 12.3.2 me këtë përmbajtje:

12.3.2.1 Çdo përdorues do të japë një diagram me një vijë të vetme që përshkruan aranzhmanet ekzistuese dhe të propozuara të gjithë aparatit që bart rrymën e ngarkesës për pikat ekzistuese dhe të propozuara të kyçjes.

Kodi i Kyçjes

Të fshihen nenet 5.2.1.1 dhe 5.2.1.2 me këtë përmbajtje:

5.2.1.1 Afatet dhe kushtet në të cilat lejohet **kyçja** në **Sistemin e Transmisionit** do të vendosen në një marrëveshje komerciale, në afate të arsyeshme, mes secilit **përdorues** dhe **OSTT**. **Marrëveshja e kyçjes (MK)** është një marrëveshje kontraktuale e veçantë mes **OSTT** dhe **përdoruesve** për secilën **pikë të kyçjes** të **Sistemit të Transmisionit**.

5.2.1.2 **OSTT** duke hyrë në një **MK** me një **përdorues** të veçantë duhet të sigurojë që sasia dhe cilësia e shërbimit të cilat pajtohet t'ia japë **përdoruesit** relevant nuk janë më pak se sa do mund të jepeshin nëse **Sistemi i Transmisionit** të planifikohet dhe të vihet në funksionim në përputhje me kriteret e vendosura brenda këtij **kodi të kyçjes**, përveç rasteve kur vendosen ndryshime specifike nga **marrëveshja e kyçjes**.

Të fshihet neni 5.3.1 me këtë përmbajtje:

5.3.1 Afatet Kohore

5.3.1.1 Afatet e parashtruara kohore për procedurën janë si më poshtë:

Veprimi	Data	Nga kush
Dorëzimi i aplikimit formal		Përdoruesi
Dërgimi i ofertës së plotësuar duke përfshirë draft MK	+ 30 ditë	OSTT
Pranimi i ofertës	+ 30 ditë	Përdoruesi
Nënshkrimi i marrëveshjes	+ 30 ditë	Përdoruesi/ OSTT
Sigurimi i të dhënave planifikuese të detajuara	+ 30 ditë	Përdoruesi

5.3.1.2 Është e rëndësishme të vihet re se afatet kohore të dhëna më lart janë afatet maksimale për kyçjet relativisht të drejtpërdrejta pritet që fazat e procesit të përfundohen në afate kohore shumë më të shkurta.

5.3.1.3 Për kyçje komplekse, që nuk mund t'iu përmbahen këtyre afateve kohore, **OSTT** do të informojë **përdoruesin** dhe do t'i ofrojë atij një afat kohor alternativ brenda 30 ditësh pas aplikimit formal.

Në Kodin e Kyçjes të bëhet referenca me Metodologjinë e Tarifave të Kyçjes.

Nenet 5.3.3.1 dhe 5.3.3.2 me këtë përmbajtje:

5.3.3.1 **OSTT** si përgjigje ndaj aplikimit të paraqitur për kyçje, duhet të vazhdojë me përgatitjen e ofertës për kyçje dhe duhet t'i japë aplikantit një ofertë të plotësuar jo më vonë se 30 ditë pas marrjes së aplikimit fillestar.

5.3.3.2 Pas marrjes së aplikimit, **OSTT** duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për ta këshilluar **përdoruesin** rreth rreziqeve dhe obligimeve në lidhje me kyçjen e propozuar të shoqëruar me ndonjë planifikim dhe legjislacion mjedisor.

Të amandmohen në këtë përmbajtje:

5.3.3.1 **OSTT** si përgjigje ndaj aplikimit të paraqitur për kyçje, duhet t'i japë aplikantit një ofertë të plotësuar brenda afatit kohor të përcaktuar në Metodologjinë e Tarifave të Kyçjes.

5.3.3.2 Kur **OSTT** siguron Ofertën për Kyçje, **OSTT** duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për ta këshilluar **përdoruesin** rreth rreziqeve dhe obligimeve në lidhje me kyçjen e propozuar të shoqëruar me ndonjë planifikim dhe legjislacion mjedisor.

Të fshihet neni 7.3.6.8 me këtë përmbajtje:

7.3.6.8 **OSTT** dhe **përdoruesi** do të shënojnë në **MK** gjegjëse, mbrojtjen përkatëse dhe akordimin e kohës së eliminimit (kvitimit) të gabimit nga secili prej tyre. Specifikat e vendit për akordimet e releve mbrojtëse dhe rregulluese dhe kohët e tyre të eliminimit të gabimeve do të regjistrohen dhe do të shënohen në listën e programit relevant të **MK** dhe do të vihen në funksionim sipas rastit. Këto programe të **MK** gjithashtu do të përmbajnë të dhëna të tjera teknike specifike të vendit të tilla si burimi i lidhjes së shkurtër tre-fazore nga **Sistemi i Transmisionit**.

Neni 7.3.9.1 me këtë përmbajtje:

7.3.9.1 Aranzhmanet e mbrojtjes dhe releve do të koordinohen për kyçjet ekzistuese, të reja dhe/ose të modifikuara dhe do të azhurnohen përmes **pikës së kyçjes** ashtu siç parashtrohet në secilën **MK** për të siguruar shkyçjen efikase të pajisjeve me defekt. Të gjitha të dhënat që kërkohen në mënyrë të arsyeshme duhet të shkëmbehen mes **palëve** në rastet kur ka ndryshime në të dhëna. Ky informacion do të përfshijë minimum:

- Nivelet e defektit dhe burimet e defektit nga **sistemi**;
- Llojin e pajisjeve mbrojtëse, kohën e eliminimit të defektit, aranzhmanet e releve;
- Aranzhmanin e mbrojtjes diferenciale për **njësinë prodhuese (gjeneruese)** /njësinë e transformatorit ngritës /linjat në distancë të shkurtër;
- Aranzhmanin e mbrojtjes të **njësisë prodhuese (gjeneruese)**;
- Mbrojtjen e zbarës;
- Aranzhmanet e mbrojtjes të **njësisë prodhuese (gjeneruese)** të ndjeshme ndaj frekuencës dhe tensionit;
- Diagramet e veprimit dhe sigurisë;
- Vizatimet e vendit

Të amandmohet me këtë përmbajtje:

7.3.9.1 Aranzhmanet e mbrojtjes dhe releve do të koordinohen për kyçjet ekzistuese, të reja dhe/ose të modifikuara dhe do të azhurnohen përmes **pikës së kyçjes** ashtu siç parashtrohet në secilën **MK** për të siguruar shkyçjen efikase të pajisjeve me defekt. Të gjitha të dhënat që kërkohen në mënyrë të arsyeshme duhet të regjistrohen në afatet kohore të MK gjegjëse dhe freskohen nga të dy **palët** në rastet kur ka ndryshime në të dhëna. Ky informacion duhet të përfshijë si minimum:

- Nivelet e defektit dhe burimet furnizuese të defektit të supozuara në kohën kur janë dakorduar aranzhimet (akordimet) e mbrojtjes.

- Llojin e pajisjeve mbrojtëse, kohën e eliminimit të defektit, aranzhmanet e releve
- Aranzhimin e mbrojtjes diferenciale për **njësine prodhuese (gjeneruese)** /njësinë e transformatorit ngritës /linjat në distancë të shkurtër;
- Aranzhmanin e mbrojtjes të **njësive prodhuese (gjeneruese)**
- Mbrojtjen e zbarës;
- Aranzhmanet e mbrojtjes të **njësive prodhuese (gjeneruese)** të ndjeshme ndaj frekuencës dhe tensionit;
- Çdo pajisje e veçantë automatike e vendosur në lokacionin specifik
- Diagramet e veprimit dhe sigurisë;
- Vizatimet e vendit